



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 19/2011
Prishtinë, më 05.07.2011, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha- Shala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Mungoi: Berat Buzhala.

Të ftuarit për raportim: Besim Beqaj, ministër i Zhvillimit Ekonomik; Frymëzim Isufaj dhe Arbnor Kastrati, këshilltarë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik- MZHE.

Pjesëmarrës të tjerë: Ismet Shala – MZHE; Ukë Gashi- ZPRK; Haxhi Gashi- USAID/ Delotte; Besim Zeqiri- ICO; Driton Selmanaj- KDI dhe Tarkan Kosova - OSBE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje propozohet ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.06.2011;
3. Raportim i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, për nivelin e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale, (I ftuar z. Besim Beqaj, ministër i Zhvillimit Ekonomik);
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.06.2011

Procesverbali nga mbledhja e datës 28.06.2011 u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, për nivelin e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale, (I ftuar z. Besim Beqaj, ministër i Zhvillimit Ekonomik)

Kryetari – Tha se siç është paraparë për këtë pikë të rendit të ditës, është raportim i ministrit Besim Beqaj, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, i cili do të paraqet një ekspozitë të shkurtër për nivelin e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-163 për miniera dhe minerale.

Besim Beqaj (ministër i Zhvillimit Ekonomik) – Fillimisht iu referua fushave që rregullon ligji dhe obligimeve që dalin nga ligji për ministrinë që ai e udhëheq. Lidhur me këtë ai tha se ligji rregullon sektorin minerar të hulumtimit, shfrytëzimit dhe pasurimit të mineraleve, paraqiti punën e MZHE- së lidhur me zbatimin e këtij ligji, njoftoi për hapat e deritashëm që ka marrë ministria për implementimin e tij. Duke folur për masat e marra nga ministria, tha se Departamenti i Minierave në kuadër të MZHE- së ka identifikuar obligimet që dalin nga ligji, në radhë të parë hartimin e rregulloreve që e plotësojnë veprimtarinë minerare. Për këtë periudhë kohore, vazhdoi ministri, Departamenti i Minierave, në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), ka përfunduar punën në gjashtë rregullore të punës dhe ka hartuar një mori të urdhërësive administrative. Ministri me këtë rast ceku Rregulloren për përmbajtjen e programit të hulumtimeve gjeologjike, Rregulloren për sigurinë minerare dhe mbrojtjen e mjedisit dhe Rregulloren për klasifikimin e resurseve minerare. Lidhur me obligimin ligjor të ministrisë, i cili parasheh funksionalizimin e Muzeut Shtetëror të Kristaleve, ministri Beqaj njoftoi se kanë filluar punimet në ndërtimin e objektit të ri të muzeut, dhe premtoi përfundim të shpejtë të punimeve. Ndër sfidat që ministri paraqiti para Komisionit me këtë rast, ishte mos miratimi i Strategjisë Minerare nga ana e Kuvendit. Lidhur me këtë ai tha: Me Strategjinë Minerare do të funksionalizohet baza legjislative e sistemit minerarë në Kosovë, përfundoi ministri Beqaj.

Sala Berisha- Shala – Theksoi se sigurisht që shumica e pyetjeve, dilemave që kanë qenë si obligim ligjor për ligjin për miniera dhe minerale i morëm nga ministri, edhe nuk është e tepërt të theksojmë se monitorimi i ligjit ka për qëllim që së pari të shohim se cilat janë pengesat në qoftë se nuk zbatohet ai ligj. Ky segment ka qenë një ndër segmentet më të barrikaduara d.m.th. sa i përket kompetencave prej UNMIK- ut te vendorët. Gjithsesi edhe pa marrë iniciativën e monitorimit të këtij ligji, jemi shumë të vetëdijshëm që duhet të plotësohet dhe ndryshohet. Mirëpo, ky monitorim neve na mundëson dhe lehtëson t'i shohim drejtpërsëdrejti pengesat që ju i keni në zbatimin e këtij ligji. Arsyeja që duhet gjithsesi të ndryshohet dhe plotësohet ky ligj është, se ish- Ministria e Energjisë dhe Minierave, është shkrire në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik edhe për faktin edhe arsyen e rregullimit të elementeve teknike që e përcjellin ligjin, siç janë p.sh., thuhet se ligjin duhet ta zbatojmë Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe këtu gjithsesi duhet të ndryshohet, se tani zbatim duhet të bëjë Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Sa i përket Instituti Gjeologjik është shumë e vërtetë që është një konfuzitet në këtë drejtim, edhe është kaluar në ato procedura dhe ka kaluar këtë kapitull sikurse komplet ligji. Ka pasur shumë dilema, debate, polemika në Komision gjatë fazave të amendamentimit rreth institutit, ku e mbroj

qëndrimin tim edhe profesional edhe personal se emërtimi nuk është i duhur dhe janë praktikat në Evropë, rajon dhe në tërë botën. Sa i përket Muzeut të Kristaleve të Kosovës, obligimi ligjor i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ka qenë që së pari ta caktojë një drejtor, sepse është kompetencë, e pastaj udhëzim administrativ, ta caktojë skemën organizative të muzeut. Të rentat e listave minerare d.m.th. presim që të hyjnë në fuqi. Më gëzon fakti që keni punë në atë drejtim, sepse neni 4 i ligjit, kemi paraparë si grup punues t'i vizitojmë edhe komunat që drejtpërsëdrejti janë të lidhura me shfrytëzimin e minierave, siç është Obiliqi, Drenasi, Mitrovica dhe ta kemi parasysh segmentin social, por sidomos edhe segmentin mjedisor, sepse ambienti është një kusht që ne synojmë të hyjmë në Evropë. Për strategjinë për minerare, në fund të mandatit të kaluar, Komisioni ka organizuar edhe dëgjime publike me ekspertë, me segmente që drejtpërsëdrejti lidhen me strategjinë dhe të gjithë janë pajtuar dhe ka qenë një prej dokumenteve të hartuar më së miri që ka ardhur në Kuvendin e Kosovës, nga ana e Qeverisë. Dhe kërkoj nga MZHE që ta sjellë në Kuvend për miratim, me disa elemente për ndryshime tepër teknike. Zonat me interes është më rendësi se si do t'i nxirrni udhëzimet administrative dhe tani sigurisht jam e bindur që ju jeni duke punuar në atë drejtim, sepse te mineralet energjetike duhet të jemi konform hapave paralel edhe me agjendën se si po shkon te termocentrali "Kosova e Re", që është shumë ngushtë i lidhur në mes vete. Mandej KPMM e ka si obligim ligjor, nga neni 74 që ta dorëzojë një projekt-plan për resurse minerale. Ne, në fund të monitorimit të këtij ligji, do organizojmë edhe një dëgjim publik, që edhe ju do të jeni të ftuar, aty do të diskutojmë, të debatojmë krejt problematikën.

Besim Beqaj (ministër i Zhvillimit Ekonomik) – Tha se sa i përket çështjes së emërimit të ligjit, ne kemi aprovuar një rregullore në Qeveri për funksionimin dhe përgjegjësit që i kanë ministrinë. Te Strategjia minerale, ne mund ta procedojmë, por do të ishte dhe është rregull procedurale nëse kthehet diçka nga Kuvendi, duhet të kthehet me një rekomandim. Ne mund ta sjellim prapë projektin, dhe prapë mund të ndodhë e njëjta gjë, dhe Kuvendi është ai autoritet final i cili do të duhet ta japë për ta miratuar ose për të mos e miratuar. Sa i përket ligjit të cilave në një formë të plotësojmë edhe këtë strategji minerale, por edhe ligjin për miniera minerale, duke e proceduar në Kuvend dhe ligjin për AKP, ligjin për Dhomën e veçantë të Gjykatës Supreme, edhe ligjin për ristrukturimin e ndërmarrjeve të veçanta, e cila mbulon dhe rregullon edhe çështjen të administrimit edhe të Trepçës dhe ndërmarrjeve të tjera.

Myzejene Selmani – Theksoi se duke marrë parasysh se Ligji për miniera dhe minerale është miratuar në legjislacionin e kaluar, ku kemi pasur mjaft vështirësi në amandamentimin e ligjit. Ne, që ishim në MZHE dhe në KPMM, duke marrë parasysh që ekskluzivisht, më shumë ky ligj e bllokoi KPMM- në, dhe çështjen e Institutit. Esenca e komplet ligjit është te Komisioni i pavarur i minierave dhe minierave, për lejimin e licencave dhe lejeve, ndërsa gjatë vizitës që e kemi pasur në ministri, kemi parë që keni startuar në plotësimin e akteve dhe udhëzimeve administrative, të cilat obligojnë MZHE- në, që menjëherë mbas hyrjes në fuqi të ligjit. Çështja e krejt procedurave të këtij ligji është edhe nxjerrja e legjislacionit sekondar që mund të them se edhe KPMM- ja është funksionale dhe kanë filluar të zbatojnë ligjin. Mirëpo kemi një vërejtje nga Raporti i progresit, diçka që duhet të jetë shumë esenciale është që duhet të përzgjedhjet e kryeinspektorit në mënyrë tjetër. Strategjia e minierave dhe mineraleve është kthyer me arsyetimin se duhet të plotësohet ana legjislative dhe me sa më informuat Ju, në Kuvend të Kosovës ka arritur ligji për AKP, dhe ligji për Trepçën, është në punim, e kemi proceduar në Qeveri.

Ramiz Kelmendi – Theksoi se te kriteret për të transferuar licencë duhet të vlejnë kriteret e reja, për licencat ekzistuese është dashur të mos vlejnë këto kriteret.

Besim Beqaj (ministër i Zhvillimit ekonomik) – Theksoi së implementimi i ligjit do të thotë të shikojmë monitorimin e funksionalizimit të ligjit. Dhe nuk është fuqi e ministrisë për ta

ndryshuar ligjin, ne të flasim për zgjidhjet administrative, se cilat janë akte nënligjore që funksionalizojnë një ligj i cili është aprovuar nga Kuvendi. Prandaj ne këtë drejtim udhëzimet të cilat Komisioni ka pasur që nuk mund të zbatohen është mirë që të qartëson për zbatimin e ligjit në jetën praktike, por udhëzimi administrativ nuk janë fuqi mbi ligjin. Sa i përket Raportit të progresit lidhur me KPMM-në për kryeinspektorin dhe Inspektorit të minierave që është përgjegjësi e Qeverisë në emërimin e tyre, ne kemi trajtuar këtë çështje, por kërkohet të jem i hapur. Ne kemi caktuar një ushtrues detyre, deri në proceduarat e ardhshme për ta rregulluar këtë çështje.

Visar Ymeri – Theksoj se sa i përket sektorit minerar, lejohet futja e kapitalit minerar, por nuk është e detyrueshme, a ka bërë MZHE-ja ndonjë plan ose ndonjë vlerësim të asaj se sa i kanë kontribuar zhvillimit të sektorit minerar? Privatizimi i disa minierave, veçanërisht te Ferronikeli? Disa raporte që janë nga agjenci të ndryshme, e fundit që kam lexuar është i “Albanin minerales” që thuhet se Kosova, me pjesën veriore të Shqipërisë e kanë një pasuri shumë të madhe të mineraleve të ndryshme, të cilat i kishin vlerësuar në 100 miliardë dollarë, MZHE-ja, a ka ndonjë vlerësim nëse ka ndonjë plan për të ardhmen se si duhet të procedohet në këtë sektor? Për rregullat e licencave dhe obligime që dalin nga aktiviteti i ndërmarrjeve tashmë të privatizuara ne miniera, a janë vetëm për ato që do të funksionalizohen si licenca, sa do të jepen në të ardhmen në këtë fushë? Për sa i përket rentave minerare që duhet t’u caktohet çmimi, se e kam parë që në buxhet nuk është paraparë që të mbledhen gjatë këtij viti?

Besim Beqaj (ministër i Zhvillimit Ekonomik) – Tha se ne, si ministri, kemi hartuar programin veprimit të planeve për zhvillim ekonomik, që brenda këtij viti do ta hartojmë një legjislacionin për modelin e aktivizimit të resurseve minerare, jemi në diskutim e sipër për ta gjetur modalitetin se si mund ta funksionalizojmë këtë sektor, por një veprim të tillë e kemi pasur të vështirë për ta zhvilluar, ndërsa s’ kemi pasur bazë legjislative. Sa i përket vlerësimeve të pasurive minerale në këtë drejtim ne kemi vlerësimet, të cilat janë bërë në të kaluarën dhe që përdoren dhe tani, janë të një metodologjie tjetër, vlerësimet që thuhet sot janë të një metodologjie dhe një sistemi, i cili duhet harmonizuar me vlerësimet e kaluar me informata të sakta, sepse ka vlerësime të ndryshme, prej vlerësimeve satelitore dhe thellësisë në tokë dhe identifikimin e mineraleve deri te hulumtimi. Sa i përket këtyre rentave unë, me thënë të drejtën, jam befasua atë ditë kur është diskutuar se aty janë të parapara në buxhet, te Ferronikli ka 2 % dhe KPMM-ja e inkason si të tillë, prandaj janë aty të parapara në buxhet.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

Konkluzion

Grupi punues do t’i evidentojë si rekomandime për MZHE si: hartimi dhe dorëzimi i Strategjisë minerare në Kuvend; nxjerrja e Akteve nënligjore; Themelimi i Institutit Gjeologjik dhe Muzeut shtetëror të kristaleve.

4. Të ndryshme

a) Konferenca “Ndikimi i legjislacionit në funksion të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit”

Kryetari - I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me organizimin e konferencës që është propozuar nga ana e Komisionit në mbështetje të UNDP- së me temën “Ndikimi i legjislacionit në funksion të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit”, që do të mbahet ditën e mërkurë, më 6 korrik 2011, duke filluar në orën 11:00, në Emerald Hotel.

b)Pjesëmarrja në seminarin “Transporti dhe infrastruktura në kontestin rajonal” më 12 dhe 13 korrik 2011, ftesa nga Parlamenti Evropian;

Kryetari – I njoftoi deputetët se delegacioni nga Komisioni do të jetë në këtë përbërje: Zenun Pajaziti kryesues, Lutfi Zharku, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq, ndërsa nga Stafi mbështetës; Armend Ademaj dhe Muhamet Morina.

c) Ndërmarrjet shoqërore të Gjakovës;

Kryetari – I njoftoi me kërkesën e deputetes Teuta Sahatqiu që në një të ardhme të afërt të vizitohet komuna e Gjakovës dhe të këtë një takim me palët e interesit, ku do të diskutohej çështja e ndërmarrjeve shoqërore të Gjakovës.

d) Strategjia minerare;

Kryetari – Kërkoi nga Stafi Mbështetës, që anëtarëve të Komisionit t’u sigurohet materiali lidhur me Strategjinë minerare 2010-2025, që është debatuar në Kuvend në Legjislaturën e kaluar, ku edhe i është kthyer Qeverisë për rihartim.

e) Takim me ZRRE;

Kryetari – E njoftoi Komisionin se do të këtë takim me kryetarin e Bordit të ZRRE- së për të marrë informacione në lidhje me disa ankesa që kanë ardhur nga disa investitorë në fushën e energjisë alternative.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit